



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 01.08.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.07.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 782, të datës 19.07.2016, paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedis, në lidhje me propozimin e Komisionit Komunal për emërtimin e shesheve dhe rrugëve në territorin e komunës së Fushë-Kosovës Nr. 780, të datës 19.07.2016, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (o), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (i), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja ((k), nenin 27, shkronja (gj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M


Për emërtimin e sheshit me emrin e z. Robert Finlayson 'Robin Cook', në Fushë-Kosovë

1. Për emërtimin e sheshit në Fushë-Kosovë me emrin e z. Robert Finlayson 'Robin Cook', Ngastra Kadastrale 678-0, Zona Kadastrale Fushë-Kosovë, në sipërfaqe prej S=00.42.88ha, në lokacionin përballë Hekurudhës.
2. Z. Robert Finlayson 'Robin Cook' është i lindur më 28 Shkurt 1946 në Bellshill të Skocisë dhe është njëri ndër personalitetet dhe diplomatët më të shquara, të diplomacisë angleze të shekullit XX i cili ka dhënë kontributin e tij për mbrojtjen dhe avansimin e kërkesave të popullit Kosovës, për pavarësi, liri dhe demokraci.
3. Kryerja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Planifikimit Urban, Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedis.
4. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Ambasadën e Britanisë së Madhe në Prishtinë, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së SHPM, Drejtorisë së KRS dhe Arkivës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 10.08.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.07.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 762, të datës 18.07.2016, paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (h), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja ((ë)), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për konfirmimin e emërtimeve të shkollave në komunën e Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin e propozimit Nr. 726, të datës 18.07.2016, për konfirmimin e emërtimeve të institucioneve edukativo-arsimore, institucionit parashkollor, shkollave fillore të mesme të ulëta dhe shkollës fillore të mesme të lartë që zhvillojnë procesin edukativ dhe arsimor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, të emërtuara më herët prej Kuvendit Komunal të Prishtinës, të regjistruara në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës, Lidhjes së Arsimitarëve Shqiptarë të Kosovës, Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës dhe të pranuar e regjistruara në Ministrinë e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë dhe Ministrinë e Financave, si vijon:
 - 1.1 Konfirmohet emërtimi - "Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë", mësimi në këtë shkollë fillon më datë 08.02.1988 si 'shkollë në themelim' dhe emërtohet në vitin 1992 nga Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë të Kosovës, prona e saj shtrihet në Ngastrën Kadastrale P-72514036-00522-0, me sipërfaqe prej 4965m² dhe Ngastrën Kadastrale P-72514036-00524-0, me sipërfaqe prej 5184m².
 - 1.2 Konfirmohet emërtimi - "Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Selman Riza' në Fushë-Kosovë", mësimi në këtë shkollë fillon në vitin 1925 në gjuhën serbe, mësimi në gjuhën shqipe zhvillohet në vitet 1941-1944 në shtëpi private, mësimi në gjuhën shqipe fillon prap në vitin shkollor 1962/1963, emërtohet në vitin shkollor 1991/1992 nga Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë të Kosovës, prona e saj shtrihet në Ngastrën Kadastrale P-72514036-00795-1, me sipërfaqe prej 3598m², Ngastrën Kadastrale P-72514036-00795-2, me sipërfaqe prej 2100m² dhe Ngastrën Kadastrale P-72514036-00792-1, me sipërfaqe prej 13946m².

1.3 Konfirmohet emërtimi - “Shkolla Fillore e Mesme e Ulët ‘Zejnel Salihu’ në fshatin Bardh i Madh”, e emërtuar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, Nr. 0.51/3677, të datës 31.08.1962 dhe të regjistruar në Gjykatën e Qarkut me vendimin Nr. FI-279/66, të datës 24.04.1966, mësimi për herë të parë ka filluar të zhvillohet në fshatin Bardh i Madh me 14.04.1946, prona e saj shtrihet në Ngastrën Kadastrale P-72514010-00810-1, me sipërfaqe prej 616m², Ngastrën Kadastrale P-72514010-00810-2, me sipërfaqe prej 1804m² dhe Ngastrën Kadastrale P-72514010-00815-0, me sipërfaqe prej 6929m². Në kuadër të shkollës amë ‘Zejnel Salihu’ kanë funksionuar paralelet e ndara fillore nëpër fshatra si vijon:

- 1.3.1 Në kuadër të shkollës amë, ‘Zejnel Salihu’ kanë funksionuar nga viti shkollor 1962/1963, paralelet e ndara fillore në tri fshatra: Graboc i Poshtëm, Pomozotin dhe Lismir;
- 1.3.2 Në vitin shkollor 1974/1975, në fshatin Lismir fillon punën shkolla tetëvjeçare, e cila pavarësohet në vitin shkollor 1993/1994;
- 1.3.3 Në vitin shkollor 1976/1977, në fshatin Graboc i Poshtëm fillon punën shkolla tetëvjeçare, e cila pavarësohet në vitin shkollor 2001/2002;
- 1.3.4 Në vitin shkollor 1987/1988, në fshatin Pomozotin fillon punën shkolla tetëvjeçare, e cila edhe sot është pjesë e shkollës amë ‘Zejnel Salihu’, prona e saj shtrihet në Ngastrën Kadastrale P-72514057-00256-0, me sipërfaqe prej 8350m² dhe Ngastrën Kadastrale P-72514057-00279-0, me sipërfaqe prej 2132m²;
- 1.3.5 Në vitin shkollor 1990/1991, hapet paralelja e ndarë fillore në fshatin Bardh i Vogël, prona e saj shtrihet në Ngastrën Kadastrale P-72514049-00197-0, me sipërfaqe prej 9845m² dhe Ngastrën Kadastrale P-72514010-00606-1, me sipërfaqe prej 29639m².

1.4 Konfirmohet emërtimi - “Shkolla Fillore e Mesme e Ulët ‘Laura Scotti’ në fshatin Graboc i Poshtëm”, veprimtare e njohur italiane, e vendosur të emërtohet me pëlqimin e Komunës së Fushë-Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, prej vitit shkollor 2001/2002, prona e saj shtrihet në Ngastrën Kadastrale P-72514028-00638-0, me sipërfaqe prej 930m² dhe Ngastrën Kadastrale P-72514028-00638-0, me sipërfaqe prej 3184m².

1.5 Konfirmohet emërtimi - “Shkolla Fillore e Mesme e Ulët ‘Lismiri’ në fshatin Lismir”, e emërtuar më datë 02.12.1992, në këtë fshat është zhvilluar mësimi nga viti 1946 si paralele e ndarë fillore e shkollës amë ‘Zejnel Salihu’ deri në vitin 1992, prona e saj shtrihet në Ngastrën Kadastrale P-72514022-00471-0, me sipërfaqe prej 3730m².

1.6 Konfirmohet emërtimi - “Shkolla Fillore e Mesme e Ulët ‘Bajram Curri’ në fshatin Sllatinë e Madhe”, e emërtuar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës Nr. 01-1870, të datës 13.03.1970 dhe të regjistruar në Gjyqin Ekonomik të Qarkut në Prishtinë me Nr. FI-445, të datës 27.12.1973, prona e saj shtrihet në Ngastrën Kadastrale P-

72514009-00416-172-0, me sipërfaqe prej 834m², Ngastrën Kadastrale P-72514009-00416-0-173-0, me sipërfaqe prej 71m², Ngastrën Kadastrale P-72514009-00093-1, me sipërfaqe prej 7911m² dhe Ngastrën Kadastrale P-72514009-00093-2, me sipërfaqe 5777m². Në kuadër shkollës amë 'Bajram Curri' funksionojnë paralelet e ndara fillore në fshatrat si vijon:

- 1.6.1 Në kuadër të shkollës amë 'Bajram Curri' funksionon paralelja e ndarë fillore në fshatin Harilaç nga viti 1968, prona e saj shtrihet në Ngastrën Kadastrale P-72514003-00580-0, me sipërfaqe prej 3093m²;
- 1.6.2 Në kuadër të shkollës amë 'Bajram Curri' funksionon paralelja e ndarë fillore në fshatin Henc nga viti 1968, prona e saj shtrihet në Ngastrën Kadastrale P-72514031-00404-0, me sipërfaqe prej 2852m².
- 1.7 Konfirmohet emërtimi - "Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Vëllezërit Frashëri' në fshatin Miradi e Poshtme", e emërtuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më datë 13.03.1970, në fshatin Miradi e Poshtme mësimi është zhvilluar për here të parë në vitin 1951, shkolla e fshatit pavarësohet me vendimin Nr. 11610 të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, të datës 28.05.1962, prona e saj shtrihet në Ngastrën Kadastrale P-72514027-00197-0, me sipërfaqe prej 8831m². Në kuadër të shkollës amë 'Vëllezërit Frashëri' funksionojnë paralelet e ndara fillore në fshatrat si vijon:
 - 1.7.1 Në kuadër të shkollës amë 'Vëllezërit Frashëri' funksionon paralelja e ndarë fillore në fshatin Miradi e Epërme, në fshatin Miradi e Epërme mësimi për herë të parë është zhvilluar në vitin 1929, prona e saj shtrihet në Ngastrën Kadastrale P-72514014-00215-0, me sipërfaqe prej 18252m²;
 - 1.7.2 Në kuadër të shkollës amë 'Vëllezërit Frashëri' funksionon paralelja e ndarë fillore në fshatin Vragoli, prona e saj shtrihet në Ngastrën Kadastrale P-72514011-00293-0, me sipërfaqe prej 17699m².
- 1.8 Konfirmohet emërtimi - "Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Daut Bogujevci' në lagjen Bresje të Fushë-Kosovës", e emërtuar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 21, të datës 03.03.2010, prona e saj shtrihet në Ngastrën Kadastrale P - 72514036-01204-0, me sipërfaqe prej 3994m² dhe Ngastrën Kadastrale P-72514036 - me sipërfaqe prej 9400m².
- 1.9 Konfirmohet emërtimi - "Shkolla Fillore e Mesme e Lartë 'Hivzi Sulejmani' në Fushë Kosovë", mësimi në gjimnaz ka filluar në vitin shkollor 1970-1971, në kuadër të kësaj shkolle të mesme ka funksionuar nga viti shkollor 1980-1981, paralelja e ndarë fizike në fshatin Bardh i Madh, shkolla pavarësohet me vendimin Nr. 61-65/82-01, të datës 25.11.1982. Me vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë Nr.

54/02, të datës 23.06.2004, shkolla e mesme riorganizohet dhe ka tri drejtime: gjimnazi ekonomia dhe teknika, prona e saj shtrihet në Ngastrën Kadastrale P-72514036-00793-1, me sipërfaqe prej 8537m².


- 1.10 Konfirmohet emërtimi i - “Institucioni Edukativ Arsimor Parashkollor ‘Gëzimi Ynë’ në Fushë-Kosovë”, ka filluar të funksionon për fëmijët e komunitetit serb nga viti 1985, institucioni parashkollor rifillon punën me 01.09.2001, prona e tij shtrihet në Ngastrën Kadastrale P-72514036-00560-1 me sipërfaqe prej 664m² dhe Ngastrën Kadastrale P-72514036-00560-2, me sipërfaqe prej 585m².
- 1.11 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët në ‘themelim’, shkolla e re në Nakarad, prona e saj shtrihet në Ngastrën Kadastrale P-72514036-00383-27, me sipërfaqe prej 2250m².
- 1.12 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët ‘Aca Marović’ në fshatin Kuzmin, prona e saj shtrihet në Ngastrën Kadastrale P-72514038-00282-0, me sipërfaqe prej 2402m².
2. Kryerja e punëve formale administrative dhe procedurave tjera për sistemimin dhe renditjen e dokumentacionit përkatës administrativ, pronësor e financiar, është në kompetencë të Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit e Pronës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Planifikimit Urban.
3. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së ARSIM-it, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së KRS dhe Arkivës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Dr.sc. Fadil Krasniqi



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 10.08.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.07.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 762, të datës 18.07.2016, paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (h), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja ((ë), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për fillimin e procedurave administrative për konfirmimin, sistemimin dhe renditjen e dokumentacionit administrativ dhe pronësor për shkollat, sipas emërtimeve të konfirmuara për shkollat në komunën e Fushë-Kosovës, me vendimin Nr. 111, të datës 11.08.2016.

1. Për fillimin e procedurave formale pronësoro-juridike, matjeve dhe vendosjes së pikave gjeodezike në terren për konfirmimin, sistemimin dhe renditjen e dokumentacionit pronësor në sistemin kadastral për evidentimin e pasurisë së institucioneve edukativo-arsimore: institucionit parashkollor, shkollave fillore të mesme të ulëta dhe shkollës fillore të mesme të lartë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Është në kompetencë të Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, kryerja e punëve dhe aktiviteteve të parapara për shënimin e caktimit e pronës dhe regjistrimin e tyre në sistemin e kadastrit, sipas emërtimeve të konfirmuara për shkollat me vendimin nr. 111, të datës 11.08.2016, në përputhje me matjet e reja gjeodezike, si vijon:
 - 2.1 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë: Ngastra Kadastrale P-72514036-00522-0, me sipërfaqe prej 4965m² dhe Ngastra Kadastrale P-72514036-00524-0, me sipërfaqe prej 5184m²;
 - 2.2 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Selman Riza' në Fushë-Kosovë: Ngastra Kadastrale P-72514036-00795-1, me sipërfaqe prej 3598m², Ngastra Kadastrale P-72514036-00795-2,

- me sipërfaqe prej 2100m² dhe Ngastra Kadastrale P-72514036-00792-1, me sipërfaqe prej 13946m²;
- 2.3 Shkolla Filllore e Mesme e Ulët 'Zejnel Salihu' në fshatin Bardh i Madh: Ngastra Kadastrale P-72514010-00810-1, me sipërfaqe prej 616m², Ngastra Kadastrale P-72514010-00810-2, me sipërfaqe prej 1804m² dhe Ngastra Kadastrale P-72514010-00815-0, me sipërfaqe prej 6929m²;
- 2.3.1 Paralelja e ndarë fillore në fshatin Pomozotin: Ngastra Kadastrale P-72514057-00256-0, me sipërfaqe prej 8350m² dhe Ngastra Kadastrale P-72514057-00279-0, me sipërfaqe prej 2132m²;
- 2.3.2 Paralelja e ndarë fillore në fshatin Bardh i Vogël: Ngastra Kadastrale P-72514049-00197-0, me sipërfaqe prej 9845m² dhe Ngastra Kadastrale P-72514010-00606-1, me sipërfaqe prej 29639m²;
- 2.4 Shkolla Filllore e Mesme e Ulët 'Laura Scotti' në fshatin Graboc i Poshtëm: Ngastra Kadastrale P-72514028-00638-0, me sipërfaqe prej 930m² dhe Ngastra Kadastrale P-72514028-00638-0, me sipërfaqe prej 3184m²;
- 2.5 Shkolla Filllore e Mesme e Ulët 'Bajram Curri' në fshatin Sllatinë e Madhe: Ngastra Kadastrale P-72514009-00416-172-0, me sipërfaqe prej 834m², Ngastra Kadastrale P-72514009-00416-0-173-0, me sipërfaqe prej 71m², Ngastra Kadastrale P-72514009-00093-1, me sipërfaqe prej 7911m² dhe Ngastra Kadastrale P-72514009-00093-2, me sipërfaqe 5777m²;
- 2.5.1 Paralelja e ndarë fillore në fshatin Harilaç: Ngastra Kadastrale P-72514003-00580-0, me sipërfaqe prej 3093m²;
- 2.5.2 Paralelja e ndarë fillore në fshatin Henc: Ngastra Kadastrale P-72514031-00404-0, me sipërfaqe prej 2852m²;
- 2.6 Shkolla Filllore e Mesme e Ulët 'Lismiri' në fshatin Lismir: Ngastra Kadastrale P-72514022-00471-0, me sipërfaqe prej 3730m²;
- 2.7 Shkolla Filllore e Mesme e Ulët 'Vëllezërit Frashëri' në fshatin Miradi e Poshtme: Ngastra Kadastrale P-72514027-00197-0, me sipërfaqe prej 8831m²;
- 2.7.1 Paralelja e ndarë fillore në fshatin Miradi e Epërme: Ngastra Kadastrale P-72514014-00215-0, me sipërfaqe prej 18252m²;
- 2.7.2 Paralelja e ndarë fillore në fshatin Vragoli: Ngastra Kadastrale P-72514011-00293-0, me sipërfaqe prej 17699m²;

2.8 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Daut Bogujevci' në lagjen Bresje të Fushë-Kosovës:
Ngastra Kadastrale P-72514036-01204-0, me sipërfaqe prej 3994m² dhe Ngastra
Kadastrale P-72514036-01200-0, me sipërfaqe prej 9400m²;

2.9 Shkolla Fillore e Mesme e Lartë 'Hivzi Sulejmani' në Fushë-Kosovë: Ngastra
Kadastrale P-72514036-00793-1, me sipërfaqe prej 8537m²;

2.10 Institucioni edukativ arsimor parashkollor 'Gëzimi Ynë' në Fushë-Kosovë:
Ngastra Kadastrale P-72514036-00560-1, me sipërfaqe prej 664m² dhe Ngastra
Kadastrale P-72514036-00560-2, me sipërfaqe prej 585m²;

2.11 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët në 'themelim', shkollë e re në Nakarad: Ngastra
Kadastrale P-72514036-00383-27, me sipërfaqe prej 2250m²;

2.12 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Aca Maroviç' në fshatin Kuzmin: Ngastra
Kadastrale P-72514038-00282-0, me sipërfaqe prej 2402m².

3. Kryerja e punëve formale administrative dhe procedurave tjera për sistemimin dhe
renditjen e dokumentacionit përkatës administrativ dhe pronësor, përgatitja e elaboratit
për secilën ngastër kadastrale të cekur në pikën dy (2) të vendimit, është në kompetencë
të Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit e Pronës dhe Drejtorisë së
Planifikimit Urban.
4. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e
Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e
komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së
ARSIM-it, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së FB, Drejtorisë
së KRS dhe Arkivës.**



**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr. sc. Fadil Krasniqi**